



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 271, datë 04.12.2019

**PËR
RIFILLIMIN E VEPRIMTARISË DHE SHËRBIMEVE GJYQËSORE NË DISA
GJYKATA TË QARKUT TIRANË, DURRËS DHE LEZHË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet, 147/1, 147/a, pika 1 germa “d” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, në Vendimin nr. 267, datë 02.12.2019 të Këshillit, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në gjykatat e qarqeve Durrës, Tiranë dhe Lezhë” pas informacioneve të marra nga kryetarët e disa gjykatave që ushtrojnë veprimtarinë në qarkun Tiranë, Durrës dhe në Lezhë

VENDOSI:

1. Rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në datën 05.12.2019 për disa gjykata të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qarkun Tiranë, Durrës dhe Lezhë, si më poshtë:
 - a) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhoma penale dhe civile);
 - b) Gjykata e Apelit Tiranë;
 - c) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë;
 - d) Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë;
 - e) Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë;
 - f) Gjykata e Rrethi Gjyqësor Durrës;
 - g) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë;
 - h) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë;
 - i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR